



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 49

Datë: 04. 08. 2021. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Qemajl Kurtisi, Fazli Stollaj

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misni; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së Nr.48/2021.

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:

3. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për certifikim të subjekteve politike.

4. Këshillat e KQZ-së:

Këshillit për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Klinës.

5. Njoftim nga Komitetit i Auditimit të Brendshëm të KQZ-së.

6. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik.

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Miratohet rendi i ditës, dhe procesverbali nga mbledhja r KQZ-së nr.48/2021.

(Stenogrami i kësaj mbledhje, është i filluar në fund të pikës nr. 3, të rendit të ditës. Në cilësinë e procesmbajtësit, nuk kam prezantuar në mbledhje për shkak të pjesëmarrjes sime në Komisionin e Konkurseve për Stafin Jo permanent. F.A.)

4. Këshillat e KQZ-së:

Këshillit për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Klinës:

Alim Rama: Në mbledhjen e funti të KOZ-it, kemi shqyrtuar zëvendësimin e anëtarit të KKZ-së nga Lëvizja “Vetëvendosje!” në komunën e Klinës për shkak të dorëheqjes së Adian Racit. Këshilli, rekomandon zëvendësimin nga Drilon Berisha.

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush lidhur me këtë rekomandim ? Nëse jo, e hedh në votim këtë zëvendësim të KKZ-së.

Miratohet, ky rekomandimi i KOZ-it.

5. Njoftim nga Komitetit i Auditimit të Brendshëm të KQZ-së:

Sami Kurteshi: Komiteti s’i një nga kërkesat e Auditorit të Përgjithshëm, është krijuar komiteti brenda KQZ-së. Pra kjo kërkesë, është plotësuar, është realizuar. Më 29 korrik kemi mbajtur takimin, jemi të konsistuar dhe komiteti është në përbërje të plotë prej 5 anëtarëve. Në mbledhje, kemi shqyrtuar dhe

miratuar statutin e Auditimit që e keni para vetës, pastaj kemi shqyrtuar, miratua planin e punës së komitetit për vitin 2021. Në pjesën e dytë, kemi shqyrtuar dhe miratuar raportin e auditorit të brendshëm. Këtë raport e keni para jush. Unë, po ua përcjellë konstatimin e Komitetit. Pra, pas nja 2 orë analize të raportit, kemi ardhur në këto konkluzione:

1. Se, në tërë procesin e tenderimit apo prokurimit, qyshdo të quhet, ka shkelje zingjirore, që në hapat e parë.
2. Komiteti ka konstatuar se kontrata është lejuar t'i jepet një kontraktori të papërgjegjshëm nga menaxhmenti i SKQZ-së.
3. Konstatimi i tretë është se ka gjeje serioze në raportin për furnizim, pra ka shkelje serioze. Është kukuar nga Komiteti që të ketë rekomandime nga adituroi, por auditori i brendshëm ka thënë se nuk ka rekomandime sepse, çështja është ex post, pra ka përfunduar dhe gjetjet janë në raportin. Anëtarët e auditimit, kanë thënë se çështja është për hetim! Po, komiteti kërkon që komitetit kërkon një plan të menagjmentit se, çfarë do të ndërmarrë në lidhje me këtë raport.

Pra, ju keni tri raporte...

Kreshnik Radoniqi: Po më duket se, anëtarët e KQZ-së, nuk janë në gjendje ta votojnë statusin e komitetit...

Sami Kurteshi: Po më duket edhe mua se, anëtarët nuk janë bash të përgatitur për shkak se mund të mos e kenë lexuar ende, por edhe çështja e përkthimit...

Arianit Elshani: E pashë materialin sipërfaqësisht, e vlerësoj punën e bërë. Nëse, dy të parat duan miratim, ne, mendoj që na duhet kohë që t'i lexojmë dhe shqyrtojmë dhe kjo është parimore, brenda ligjit...

Kreshnik Radoniqi: Po më duket sa pajtohem që ta lëmë për mbledhjen e ardhshme: statusin dhe planin e punës...

Alim Rama: Sa u përket dy pikave të para pajtohem, por pika e tretë, mendoj që raporti është shqetësues, sepse kur i lexon këto të gjetura: një kontratë e shtrenjtë 140 000 euro, me të vërtetë raporti është shqetësues...Kisha kërkuar që, a ka mundësi me ba një krahasim sepse ne edhe në zhdredhjet e nëntorit kemi blerë kësi material, pra sa ka kushtua kosoto për një vendvotim në zgjedhjet e nëntorit, dhe sa tash...?

Të gjeturat, janë shqetësuese...

Kreshnik Radoniqi: Po mendoj që kjo s'është çështje e jona me bërë krahasimin, por e hetuesisë...

Sami Kurteshi: Kemi pasur diskutime të ndryshme, pyetje, dhe çështje apo pasqyra financiare dhe se, kemi konstatuar se operatori ka qenë i papërgjegjshëm...! Disa çështje, nuk janë punë as të auditorit të brendshëm. Ne, nuk kemi marrë ndonjë vendim sepse, ne s'kemi mundur ta bëjmë atë..

Ibrahim Selmanaj: Diskutimet kanë qenë të gjata, dhe të gjeturat janë faktike. Konstatimet, janë siç u tha, pra edhe brenda komitetit kemi ardhur në përfundim se menaxhmenti duhet të ndërmarrë masa ndaj atyre që i kanë kryer procedurat. Do të thotë, është detyrë, në rastin konkret e Krye shefit ekzekutiv që të merr masa me zhvillimin e procedurave që kanë ndodh...

Sami Kurteshi: Komiteti kërkon një plan të veprimit se çka do të ndërmerret në raport me të gjeturat e këtij raporti...

Florian Dushi: S'i institucion, po konsideroj që për ne është me rëndësi që po e vërejmë se ky "zingjiri" i përgjegjësive tona të ndara, po funksionon dhe ka arritur në konkluzione të qarta rreth një procesi që janë ngritur shqetësime brenda këtij institucioni. Është me rëndësi që menaxhmenti ta sheh, dhe në kuadër të masave dhe procedurave të parapara disiplinore, ti zhvillojë këto masa: pra. Të shoh nëse ka pasur shkelje...Pjesa tjetër, nuk është në dorën tonë...Por, konsideroj se zyrtarët tanë do ta ngritin përgjegjësinë, me gjithë faktin se ne pak kemi pasur njohuri rreth tregut, sidomos rreth maskave mbrojtëse ku kemi pasur në fillim çmime të shtrenjta dhe më vonë të lira... Megjithëse, këto rrethana duhet ti kemi parasysh, por pjesa e menaxhmentit duhet ti kryej punët e veta në raport me atë cka është konkluzion i auditorit të brendshëm...

6. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik.

Fazli Stollaj: Në lidhje me mbikëqyrjen e Informimit Publik, nga mbledhja e funit e KQZ –së kemi mbajtur dy takime ku janë shqyrtuar: në mbledhjen e parë të mbajtur ka shqyrtuar videon dhe videos potin që ka të bëjë me "Periudhën e ndrrimit të Qendrave të Votimit", dhe "Mediaplanin" për transmetim të videove dhe radio spoteve dhe për sponsorisim të këtij materiali në portale dhe rrjete sociale!

Ky videspot është duke u transmetuar në rrejtët sociale të KQZ-së, të Komunave dhe në rrjetet sociale ndërsa, sa i përket vidës potit dhe radios potit që ka të bëjë me "Votuesit me nevoja të veçanta", është shqyrtuar sot me 4 gusht: teksti është shqyrtuar, dhe posterit dhe dizajni që ka të bëjë me postimet lidhur me këtë fushatë...

E keni edhe një raport papara vetës...

Sami Kurteshi: Ne, në mbledhjen e fundit kemi pasur diskutimin dhe, kemi pasur pyetjen lidhur me integrimin e të gjitha mediave, por në ndërkohë, kemi marrë imela nga dy medime ku, ata shprehin pakënaqësi lidhur me KQZ-në lidhur me trajtimin e tyre jo të barabartë...!

Ka pasur kritere, por shqetësimet e atyre mediave është i drejtë, sepse kemi të bëjmë veç bartjes së porosive, kemi të bëjmë edhe me pagesë, pra me ndarjen e mjeteve publike për një qëllim, dhe përjashtimi dhe futja e disave, është problemi...Pra, nuk është në pyetje shikueshmëria, por dallimi dhe, ne nuk kemi kritere...

Florian Dushi: Kam edhe unë çështjen e njëjtë, e kemi ngritur në takimin e fundit dhe kemi kërkuar të shihen mundësitë që të përfshihen edhe dy medime, por nuk kemi ndonjë raportim...Kemi pranuar letra, imela nga dy televizione...Prandaj, Këshilli për IP, të sheh mundësinë që të përfshihen edhe këto media, duke evituar kështu “ndarjen apo diskriminimin” KQZ...

Ilir Gashi: Edhe unë ndaj shqetësimin, pra pse të mos përfshihen edhe televizionet lokale ku ka shikueshmëri, pra edhe në radio dhe televizione...Selektimi, është i vërejtshëm...

Lidhur me diskutimin e këtij konteksti rreth pakënaqësive të media në raport me tenderin për IP, z. Stollaj tha se janë shqyrtuar ankesat e dy medimeve dhe se ne kemi ardhur në përfundim se, duhet ta respektojmë kontratën...Operatori e bënë pagesën! Këshilli, vetëm e bënë përcaktimin për cilat medime...Medimet, janë të limituara: tri medime nacionale, dhe tri tjera...nuk kemi mundur më shumë...

Kriteri, ka qenë kohëzgjatja e periudhës që tri medimet janë më të vjetrat, dhe numri ka qenë i kufizuar. S’kemi mundur më shumë se 6 medime, nuk ka pasur ndonjë thirrje që, “ta zgjedhim dikën dhe ta përjashtojmë dikën tjetër” !

Në këtë pikë, shpjegime dha edhe Arianit Elshani, si anëtar i KMIP se me strategjinë e re, janë shtuar edhe tri hapësira të reja të medimeve televizive, dhe si kriter ka qenë “matja e shikueshmërisë”, dhe se ndonëse kemi kërkuar nga KPM të dhëna të shikueshmërisë por, ne s’kemi marrë përgjigje...Por, ne kemi qenë empirik aq sa kemi mundur...Sot, edhe po e shfrytëzoj rastin që KPM të na ofroj të dhëna...

Ne, s’kemi pasur tjetër kriter, veçse përvojën dhe moshën e kanaleve që kemi përzgjedhur...

Në këtë pikë, diskutuan gjerë e gjatë edhe Florian Dushi, Sami Kurteshi, i cili tha se kontrata në parim është diskriminuese, Alim Rama, Ilir Gashi, Kreshnik Radoniqi, si edhe Burim Ahmetaj.

Të ndryshme !

Kreshnik Radoniqi: Kam një çështje dhe, kjo ka të bëj me ri formatimin e këshillave, meqë edhe tani jemi në përbërje të plotë. Pra, nëse pajtoheni, ne ta caktojmë një datë që bashkërisht ta shqyrtojmë këtë temë dhe, ta caktojmë një datë...Mbase, janë tjetër...

Florian Dushi, tha se, pjesë e agjendës të jetë edhe formimi i një këshilli të ri, themelimin edhe të këshillit për Informim Publik...